



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

## NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti:** Bashkimi i shoqërisë Peugeot S.A. dhe shoqërisë Fiat Chrysler Automobiles N.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa Nr. 30 Prot., protokoll i AK, datë 15.01.2020 “Aplikim i shkurtuar për njoftim përqendrimi”, ku përfaqësuesi ligjor ka njoftuar lidhur me transaksionin e propozuar që pritet të ndodhë midis Peugeot S.A. nga Fiat Chrysler Automobiles N.V.

Palët kanë nënshkruar “Marrëveshjen e kombinimit nga dhe ndërmjet Fiat Chrysler Automobiles N.V. dhe Peugeot S.A.” më datë 17 Dhjetor 2019.

Palët pjesëmarrëse<sup>1</sup>:

**Fiat Chrysler Automobile N.V. (FCA)** është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive FCA. Grupi FCA është një grup global i angazhuar në dizenjimin, projektimin, prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e mjeteve të transportit të markave Abarth, Alfa Romeo, Chrysler, Dodge, Fiat, Fiat Profesional, Jeep, Lancia dhe Ram, si edhe në dizenjimin e mjeteve të transportit me performancë SRT (Street & Racing Technology). FCA mbështet dërgesat e saj të mjeteve të transportit me shitjen e shërbimeve, pjesëve dhe aksesorëve përkatës, si dhe të kontratave të shërbimit në mbarë botën të markës Mopar për mjetet e transportit të tregut në masë. Për më tepër, FCA dizenjon, projekton, prodhon, shpërndan dhe shet mjete transporti luksoze të markës Maserati.

**Peugeot S.A.** është shoqëria zotëuese e shoqërive të grupit PSA. Grupi PSA është kryesisht një prodhues origjinal pajisjesh dhe tregtar i mjeteve motorike transporti, makinave të pasagjerëve si dhe të LCV-ve të markave Peugeot, Citroen, Opel, Vauxhall dhe DS. Ajo ofron gjithashtu shërbime të tjera ndihmëse, siç janë zgjidhjet financuese për blerjen e mjeteve motorike të transportit. Gjithashtu, PSA, nën markën Free2Move, është një ofrues i shërbimeve dhe zgjidhjeve lëvizëse. Aktivitete e PSA-s janë të organizuar rreth tre grupeve kryesore:

- Grupi i automjeteve që mbulon dizenjon, prodhimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve dhe LCV të markave Peugeot, Citroen, Opel, Vauxhall dhe DS.

---

<sup>1</sup> Burimi: Formulari i Njoftimit të Përqendrimit.

- Grupi i financës që i korrespondon filialet Banque PSA Financë të PSA-s i cili ofron financimin e konsumatorëve për shitjen me pakicë të pesë markave të PSA-së, përmes shoqërive të financimit të dedikuar. Ky grup ofron dhe shpërndan gjithashtu siguracione dhe shërbime të tjera ndihmëse.
- Biznese të tjera përfshijnë shoqërinë zotëruese të grupit dhe aktiviteteve të tjera anësore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**